



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:015254
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05262632

C.nr.2887/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Florid Hasku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses S..S, nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës, me seli në Gjakovë, për kompensimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit, jashtë seance, me datën 31.01.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Paditësit S.s, nga Gjakova, i KTHEHET në plotësim padia e parashtruar me datë 26.12.2023, që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë me provat e caktuara.
- II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia po që së nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

A r s y e t i m

Paditësja S.S., nga Gjakova, pranë kësaj gjykate me datë 26.12.2023, përmes të autorizuarit të saj Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjeti se e njëjta nuk është e pajisur me provat me të cilat vërtetohen pretendimet e paditëses, përkatësisht nuk ka prova me të cilën vërtetohet paditësja ka qenë e licencuar, në shkresat që i janë bashkëngjitur padisë mungon licenca e punës për paditësen.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të nenit 99 par.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.2887/23, me datë 31.01.2024

Gj y q t a r i
Florid Hasku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.